

ABI INVEST SHA

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2021
(me opinionin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

PËRMBLEDHJE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
1. Njësia raportuese	6
2. BaZA E PËRGATITJES	6
3. Ndryshimet në politikat kontabël	7
4. Politikat kontabël	10
5. Menaxhimi i riskut financiar	12
6. PARAQITJA DHE VLERESIMI I VLERES SE DREJTE	14
7. Aktive Afatgjata jo materiale	15
8. Investime Financiare	15
9. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHMEt me to	15
10. DETYRIME TE TJERA	16
11. KAPITALI AKSIONAR	16
12. Të ardhura nga interesat	16
13. TË ARDHURA NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET	16
14. SHPENZIMET E PERSONELIT	16
15. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE	17
16. TATIM FITIMI	17
14. TATIM FITIMI (vAZHDIM)	17
17. VEPRIME ME PALET E LIDHURA	18
18. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara	18
19. Ngjarje të mëpasshme	19

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarin e “ABI Invest sh.a”,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “ABI Invest sh.a.” (këtu e më poshtë referuar “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

30 Prill 2022

Kedion Kodra, FCB



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021 Lekë	31 dhjetor 2020 Lekë
Aktivët			
Aktive afatgjata jo materiale	7	7,152,961	7,324,442
Investime Financiare	8	22,999,752	-
Mjetet monetare dhe të ngjashme me to	9	1,543,127	33,754,996
Aktive të Tjera		319,273	-
Totali i aktiveve		32,015,113	41,079,438
Detyrimet			
Detyrime të tjera	10	941,161	2,138,253
Totali i detyrimeve		941,161	2,138,253
Kapitali			
Kapitali aksionar	11	45,000,000	45,000,000
Rezerve Rivlerësimi		24,608	-
Fitimi (humbja) e mbartur		(6,058,815)	-
Fitimi (humbja) e periudhës		(7,891,841)	(6,058,815)
Totali kapitalit		31,073,952	38,941,185
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		32,015,113	41,079,438

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Shënime		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
		Lekë	Lekë
Të ardhura nga interesat	12	502,903	-
Shpenzime për interesa		-	-
Të ardhura nga interesat, neto		502,903	-
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	13	2,724,341	-
Shpenzime për tarifa dhe komisione	13	(66,714)	(29,063)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto		2,657,627	(29,063)
Fitim/humbje nga kurset e këmbimit		2,174	(1,722)
Të ardhura te tjera, neto		2,174	(1,722)
Shpenzime personeli	14	(6,042,265)	(4,600,699)
Shpenzime administrative	15	(3,245,127)	(1,427,331)
Zhvierësimi dhe amortizimi	7	(1,767,153)	-
Totali i shpenzimeve		(11,054,545)	(6,028,030)
Humbja para tatim fitimit		(7,891,841)	(6,058,815)
Shpenzimi i tatim fitimit		-	-
Humbje neto e periudhës		(7,891,841)	(6,058,815)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		(24,608)	-
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën, neto		(7,916,449)	(6,058,815)

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar në emër të Shoqërisë më 30 Prill 2022 nga:

[Signature]

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



ABI INVEST SH.A.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	Humbja e akumuluar	Totali
	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000,000	-	-	25,000,000
Humbja e periudhës	-	-	(6,058,815)	(6,058,815)
Totali i të ardhurave/ (humbjeve) gjithëpërfshirëse	-	-	(6,058,815)	(6,058,815)
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital				
Kontribute të aksionarëve (shënimi 10)	20,000,000	-	-	20,000,000
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	20,000,000	-	-	20,000,000
Gjendja më 31 dhjetor 2020	45,000,000	-	(6,058,815)	38,941,185
Humbja e periudhës	-	-	(7,891,841)	(7,891,841)
Ndryshimi në zhvlerësimin e letrave me vlerë	-	24,608	-	24,608
Totali i të ardhurave/ (humbjeve) gjithëpërfshirëse	-	24,608	(7,891,841)	(7,867,233)
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital				
Kontribute të aksionarëve (shënimi 10)	-	-	-	-
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	45,000,000	24,608	(13,950,656)	31,073,952

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Shënime		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
		Lekë	Lekë
Humbje para tatim fitimit		(7,891,841)	(6,058,815)
Rregullimet për:			
Shpenzime të tjera		-	-
		(7,891,841)	(6,058,815)
Ndryshimet ne:			
Rritje në aktive të tjera	8	(147,792)	(7,324,442)
Rritje në detyrime të tjera	9	(1,197,092)	2,138,253
Flukset e parasë te gjeneruara nga aktiviteti operativ		(9,236,725)	(11,245,004)
Flukset e parasë nga veprimtaritë Investuese			
Blerje neto të investimeve në letra me vlerë të vendosjes		(22,999,752)	-
Shitje të investimeve Financiare - VDATGJ		24,608	
Flukset e parasë te gjeneruara nga veprimtaritë investuese		(22,975,144)	-
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese			
Rritja e kapitalit aksionar	10	-	20,000,000
Flukset e parasë te gjeneruara nga veprimtaritë financuese		-	20,000,000
Rënia/ (rritja) në mjetet monetare dhe ekuivalentet		(32,211,869)	8,754,996
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me 01 janar 2021	7	33,754,996	25,000,000
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me 31 dhjetor 2021	7	1,543,127	33,754,996

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. NJËSIA RAPORTUESE

ABI INVEST sh.a. është një institucion financiar i regjistruar si Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive bazuar në ligjin 56/2020, datë 30.04.2020.

Aktiviteti i Shoqërisë i nënshtrohet Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" hyrë në fuqi më 30 Prill 2020 (duke shfuqizuar Ligjin nr. 10 198 datë 10.12.2009 dhe çdo akt tjetër që bie ndesh me të), Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe është në përputhje me të gjitha aktet nën-ligjore të aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Shoqëria është regjistruar si Shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër regjistrimi (NUIS) L92424002L më 24 dhjetor 2019 dhe është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me datë 27.02.2020. Fondi i parë i licencuar i Shoqërisë është "ABI EIA" si sipërmarrje e investimeve kolektive me vendimin nr. 203 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare më datë 29 dhjetor 2020. . Fondet ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD janë licencuar nga Autoriteti me vendimet nr. 110 dhe 112 datë 30.06.2021.

Selia Qendrore e Shoqërisë "ABI INVEST sh.a." është: Rruga e Kavajës, ndërtesa nr.27, Hyrja 1. Kati II, Njësia Bashkiake 10, Kodi Postar 1001.

Shoqëria zotërohet 100% nga "Banka Amerikane e Investimeve sh.a." ("Mëma") që nga data e themelimit të saj. Shoqëria "ABI Invest sh.a." funksionon si Shoqëri aksionare me sistem administrimi me një nivel.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 3 (tri) (2020: 3).

Drejtuesit dhe administrimi i shoqërisë më 31 dhjetor 2021 përbëhet si më poshtë:

Këshilli i Administrimit

Anëtar - Armand Muharremi

Anëtar - Brikena Hoxha

Anëtar - Teuta Çinari

Anëtar - Redi Hakani

Administrator – Redi Hakani

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë të miratuara nga Drejtimi i Shoqërisë më datë 30 Prill 2022. Shoqëria meme "Tranzit sh.p.k." përgatit pasqyrat e konsoliduara për të gjithë grupin duke përfshirë "Bankën Amerikane të Investimeve sh.a.", "ABI Invest sh.a." dhe "ABI Broker sh.a."

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Këto pasqyra financiare të Shoqërisë janë paraqitur në Lek Shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Menaxhimi i Shoqërisë ka bere vlerësimin e aftësisë se saj për te vijuar biznesin ne baze te parimit te vijimësisë, përfshirë ndikimin e pandemisë COVID-19, dhe është i kënaqur qe ka burime për te vazhduar ne biznes për te ardhmen e parashikueshme nga mbështetja e siguruar nga Mema për fillimin dhe zgjerimin e aktivitetit. Menaxhimi nuk ka identifikuar pasiguri materiale qe mund te hedhin dyshime te rëndësishme ne aftësinë e Shoqërisë për te vazhduar veprimtarinë dhe për këtë arsye përgatitja e pasqyrave financiare ne baze te parimit te vijimësisë mbetet e përshtatshme.

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare ne përputhje me SNRF-te kërkon qe Drejtimi te beje gjykime, vlerësime dhe supozime te cilat ndikojnë ne aplikimin e politikave kontabël dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet baze rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen ne periudhën ne te cilën ndodh rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe afektohen/preken nga këto ndryshime. Drejtimi beson se vlerësimet dhe supozimet baze janë te duhura dhe se, si rrjedhoje, pasqyrat financiare paraqesin sakte pozicionin dhe rezultatin financiar. Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rëndësishme te vlerësimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabël te cilat kane efektet me te rëndësishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, janë përshtatshme ne shënimet përkatëse te pasqyrave financiare.

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL

3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo detyruesisht efektive, Standarde dhe Ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3) - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021
- Përkufizimi i materialitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8) - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm.
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm.

Këto standarde ose ndryshimet në standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk pritët të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria (vazhdim)

Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialit

Në tetor 2019, IASB lëshoi ndryshime në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet për të lidhur përcaktimin e "materialit" përmes standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se, 'Informacioni është material nëse heqja, deklarimi i gabuar ose fshehja, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të qëllimeve të përgjithshme bëjnë mbi bazën e atyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion financiar për një njësi specifike raportuese.' Ndryshimet në përcaktimin e materialit nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Reforma e Standardit të Normës së Interesit: Ndryshime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7

Ndryshimet në Reformën e Standardit të Normës së Interesit në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 përfshijnë një numër lehtësimesh, të cilat vlejnë për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse, të cilat preken drejtpërdrejt nga reforma e normave të interesit. Një marrëdhënie mbrojtëse ndikohet nëse reforma shkakton paqartësi në lidhje me kohën dhe ose shumën e fluksit monetar të parave të bazuara në vlerësimin e sendit të mbrojtur ose instrumentit mbrojtës. Ndryshimi është në fuqi nga 1 janar 2019. Shoqëria nuk pret një ndikim të rëndësishëm nga ky ndryshim.

Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Kuadri Konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Korniza Konceptuale) nuk është një standard, dhe asnjë prej koncepteve nuk i tejkalon ato me ndonjë standard ose ndonjë kërkesë të një standardi. IASB nxori Kuadrin Konceptuale në Mars 2019. Ai përcakton një grup gjithëpërfshirës të koncepteve për raportimin financiar, vendosjen standarde, udhëzime për përgatitësit në zhvillimin e politikave të qëndrueshme të kontabilitetit dhe ndihmë për të tjerët në përpjekjet e tyre për të kuptuar dhe interpretuar standardet.

Kuadri Konceptual përfshin disa koncepte të reja, ofron përkufizime të azhurnuara dhe kritere të njohjes për aktivet dhe detyrimet dhe sqaron disa koncepte të rëndësishme.

Shoqëria do të aplikoje standardet e mëposhtme kur ato të hyjnë në fuqi, por nuk pret që të ketë një ndikim në pasqyrat e saj financiare sepse këto nuk janë të zbatueshme për Bankën.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023).

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (d.m.th., sigurimi i jetës, jo-jetës, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe ri-sigurimi), pavarësisht nga lloji i njërive ekonomike që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiarë me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale.

SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një përshtatje specifike për kontratat me tipare të pjesëmarrjes direkte (qasja e tarifës së ndryshueshme)
- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontratat me kohëzgjatje të shkurtër.

Matja e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, duke përfshirë një rregullim të qartë të rrezikut, rimatë çdo periudhë raportuese (përmeshja e flukseve të parasë). Një Marzhë e Shërbimit Kontraktual (CSM) që është e barabartë dhe e kundërt me çdo ditë fitimi në përmeshjen e flukseve të parave të gatshme të një grupi kontratash, që përfaqëson fitimin e pafituar të kontratave të sigurimit që do të njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së shërbimit (d.m.th., periudha e mbulimit). Ndryshime të caktuara në vlerën aktuale të pritshme të flukseve të ardhshme të parave rregullohen kundrejt CSM dhe në këtë mënyrë njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së mbetur të shërbimit kontraktual.

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria (vazhdim)

Ndryshimet në SNK 16: Prona, objektet dhe pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar, efektive më ose pas 1 janarit 2022

Ndryshimi ndalon njësitet ekonomike të zbresin nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale (AAM), të gjitha të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa e sjellin atë aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ajo të jetë e aftë të veprojë në këtë mënyrë, të destinuara nga menaxhimi. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njihet të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje.

Ndryshimi duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive vetëm për zërat e AAM të vënë në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

AIP SNRF 9 Instrumentet Financiare - Tarifat në testin e '10 përqind 'për mosnjohjen e detyrimeve financiare, efektive në ose pas 1 janarit 2022

Ndryshimi sqaron tarifat që një njësi ekonomike përfshin kur vlerëson nëse kushtet e një detyrimi të ri financiar ose të modifikuar janë thelbësisht të ndryshëm nga kushtet e detyrimit original financiar. Këto tarifa përfshijnë vetëm ato të paguara ose të marra ndërmjet huamarrësit dhe huadhënësit, duke përfshirë tarifat e paguara ose të marra nga huamarrësi ose huadhënësi në emër të tjetrit. Nuk ka ndonjë ndryshim të ngjashëm të propozuar për SNK 39.

Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente, efektive më ose pas 1 janarit 2022

E drejta për të shtyrë shlyerjen

Nëse e drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi i nënshtrohet njësisë ekonomike në përputhje me kushtet e specifikuara, njësia ekonomike ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e detyrimit në fund të periudhës së raportimit nëse është në përputhje me ato kushte në atë datë.

Ekzistenca në fund të periudhës raportuese

Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se kërkesa për të drejtën për të ekzistuar në fund të periudhës së raportimit zbatohet pavarësisht nëse huadhënësi teston për pajtueshmëri në atë datë apo në një datë të mëvonshme.

Pritjet e menaxhimit

SNK 1.75A është shtuar për të sqaruar se 'klasifikimi i një detyrimi nuk preket nga gjasat që njësia ekonomike të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit'. Kjo është, qëllimi i drejtimit për t'u vendosur në një periudhë afatshkurtër nuk ndikon në klasifikim. Kjo vlen edhe nëse shlyerja ka ndodhur kur pasqyrat financiare janë të autorizuar për lëshim.

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (vazhdim)

3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Banka (Vazhdim)

Kuptimi i termit 'shlyerje'

Shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet nësisë ekonomike konsiderohet shlyerje për qëllim të klasifikimit të detyrimeve si korente ose jo-korente, me një përjashtim. Në rastet kur një opsion shndërrimi klasifikohet si një detyrim ose pjesë e një detyrimi, transferimi i instrumenteve të kapitalit neto do të përbënte shlyerjen e pasivit me qëllim të klasifikimit të tij si aktual ose jo-aktual. Vetëm nëse vetë opsioni i konvertimit klasifikohet si një instrument i kapitalit neto, shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet nuk do të merret parasysh kur përcaktohet nëse detyrimi është aktual ose jo rrjedhës. E pandryshuar nga standardi aktual, një qarkullim i huamarrjes konsiderohet zgjatje e një detyrimi ekzistues dhe për këtë arsye nuk konsiderohet të përfaqësojë 'shlyerje'.

Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i një biznesi, efektiv më ose pas 1 Janarit 2019.

Ndryshimet në SNRF 3: Referenca në Kuadrin Konceptual, efektive më ose pas 1 Janarit 2022.

Ndryshimet në SNK 37: Kostot e Përbushjes së Kontratës, efektive më ose pas 1 Janarit 2022

AIP SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si adoptues për herë të parë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

AIP SNK 41 Bujqësia - Taksimi në matjet e vlerës së drejtë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një investitori dhe ndërmarrjes së tij të përbashkët ose ndërmarrjes së përbashkët.

4. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

4.1 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetar është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejt rikëmbehen në monedhën funksionale me

kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejt. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shoqëria nuk ka transaksione në monedhe të huaj për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro/Lek	120.76	123.70
USD/Lek	106.54	100.84

4. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Interesat

Sipas SNRF 9, të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiare. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohej ekzaktesisht pagesat e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose kur është e përshtatshme, për periudhën me të shkurtër), duke arritur në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet, Shoqëria i përlogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivit financiar. Shoqëria nuk ka aktive financiare të zhvlerësuar.

4.3 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitim humbjeve të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbljedhëse. Shoqëria nuk ka tatim mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.

4.4 Instrumentet Financiare

4.4.1 Data e njohjes

Aktivitet dhe detyrimet financiare fillimisht njihen në datën e tregtimit që është data në të cilën shoqëria behet pale në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin mënyrën standarde të tregtimit; blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë dorëzimin e aktiveve brenda një afati kohor, përgjithësisht të përcaktuar me rregullore apo konvente në treg.

4.4.2 Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termit e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejte për të cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë. Llogarite e arkëtueshme maten me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejte e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Shoqëria regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së pare.

4.4.3 Përlogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë HPK-se

Shoqëria ka vetëm llogari rrjedhëse me Mëmën për të cilat nuk pret të ketë humbje të pritshme të kredisë materiale

4.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përfshijnë llogari rrjedhëse në banke likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejte, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuara në pasqyrën e të pozicionit financiar.

4.5.1 Matja e vlerës së drejte

'Vlera e drejte' është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrës në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun me të favorshëm në të cilin Shoqëria ka akses në atë datë.

Për të treguar se si janë nxjerre vlerat e drejta, instrumentet financiare janë riklasifikuar bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhet më poshtë:

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj (Vazhdim)

4.5.1 Matja e vlerës së drejte (Vazhdim)

- Niveli 1: Ato ku inputet e përdorura në vlerësim janë çmimet e kuotuar të parregulluara në tregjet aktive për një instrument identik në të cilat Shoqëria ka qasje në datën e matjes.
- Niveli 2: Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen me pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimi përfshijnë inpute të cilat nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të ketë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme, ku rregullime të rëndësishme të pavëzhgueshme ose supozime janë të nevojshme për të reflektuar diferencat midis instrumenteve

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktiviteti i Shoqërisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i likuiditetit, risku i kredisë, risku i normës së interesit dhe risku i kursit të këmbimit, vlerësimi i të cilave është paraqitur më poshtë. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në paparashikueshmërinë e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndërmerret nga departamenti i financës i kompanisë sipas politikave të aprovuara.

(i) Risku nga kursi i këmbimit

Rreziku ndaj riskut të kursit të këmbimit vjen si rezultat i ekspozimit të Shoqërisë ndaj monedha të ndryshme. Shoqëria nuk ka aktive ose detyrime financiare në monedhe të huaja, dhe si rrjedhojë, nuk ka ndjeshmëri ndaj ndryshimeve të mundshme të kurseve të këmbimit.

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 sipas monedhave përkatëse:

	Leke	USD	Euro	Totali
31 dhjetor 2021				
Mjete Monetare	1,543,142	(1,103)	1,087	1,543,127
Letrat me vlerë me vlerë të drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	22,999,752			22,999,752
Aktive të tjera	319,273	-	-	319,273
Totali	24,862,167	(1,103)	1,087	24,862,152
Detyrime të tjera	941,161	-	-	941,161
Totali	941,161	-	-	941,161
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2021	25,803,328	(1,103)	1,087	25,803,313
	Leke	USD	Euro	Totali
31 dhjetor 2020				
Mjete Monetare	33,754,996	-	-	33,754,996
Aktive të tjera	7,324,442	-	-	7,324,442
Totali	41,079,438	-	-	41,079,438
Detyrime të tjera	2,138,253	-	-	2,138,253
Totali	2,138,253	-	-	2,138,253
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2020	38,941,185	-	-	38,941,185

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumatat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(ii) Risku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera një instrument financiar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti.

Shoqëria ka vetëm mjete monetare me Mëmën dhe ekspozimi ndaj këtij rreziku është jo material.

Tabela e mëposhtme jep informacion për cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuara dhe vlerë të drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, për aktivet financiare, vlerat e paraqitura në tabele paraqesin vlerën e mbetur bruto.

	Më 31 dhjetor 2021					Më 31 dhjetor 2020
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
Mjete Monetare						
Risk i ulet	1,543,127	-	-	-	1,543,127	33,754,996
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	1,543,127	-	-	-	1,543,127	33,754,996

	Më 31 dhjetor 2021					Më 31 dhjetor 2020
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
Letrat me vlerë-VDATGJ						
Risk i ulet (vlera bruto)	22,975,144	-	-	-	22,975,144	-
Pakësuar/shtuar me rivlerësimin	24,608	-	-	-	24,608	-
Vlera e mbartur	22,999,752	-	-	-	22,999,752	-

	Më 31 dhjetor 2021					Më 31 dhjetor 2020
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
Aktive të tjera						
Risk i ulet	319,273	-	-	-	319,273	7,324,442
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	319,273	-	-	-	319,273	7,324,442

(iii) Risku i normës së interesit

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës së interesit. Kompania nuk ka instrumente që ndikohen në mënyrë domethënëse nga përqindja e interesit.

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(iv) Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballlet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria nuk ka detyrime financiare dhe rrjedhimisht nuk është e ekspozuar ndaj këtij rreziku.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 sipas maturitetit të mbetur duke marrë në konsideratë fluksin e parave të paskontuar sipas maturitetit kontraktual dhe duke reflektuar supozime për ri-pagesa të hershme apo duke përdorur të dhënat historike.

31 dhjetor 2021	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Totali
Mjete Monetare	1,543,127	-	-	1,543,127
Letrat me vlerë VDATGJ	22,999,752	-	-	22,999,752
Totali	24,542,879	-	-	24,542,879
Detyrime të tjera	941,161	-	-	941,161
Totali	941,161	-	-	941,161
Hendeku i likuiditetit me 31.12.2021	23,601,718	-	-	23,601,718
Kumulative	23,601,718	23,601,718	23,601,718	-

31 dhjetor 2020	Me pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	Me shume se 1 vit	Totali
Mjete Monetare	33,754,996	-	-	33,754,996
Totali	33,754,996	-	-	33,754,996
Detyrime të tjera	2,138,253	-	-	2,138,253
Totali	2,138,253	-	-	2,138,253
Hendeku i likuiditetit me 31.12.2020	31,616,743	-	-	31,616,743
Kumulative	31,616,743	31,616,743	31,616,743	-

6. PARAQITJA DHE VLERESIMI I VLERES SE DREJTE

Shoqëria ka vetëm mjete monetare që përfshijnë llogari rrjedhëse me Mëmën dhe vlera e tyre e drejte konsiderohet të jetë e njëjtë me vlerën kontabël të tyre.

Tabela e mëposhtme tregon vlerën e drejte të aktiveve financiare dhe analizon ato nga hierarkia e vlerës së drejte në të cilën është klasifikuar.

	Me 31 dhjetor 2021			
	Vlera e mbartur	Vlera e drejte Niveli 1	Vlera e drejte Niveli 2	Vlera e drejte Niveli 3
Aktive financiare				
Mjete Monetare	1,543,127	-	-	1,543,127
Letrat me vlerë me vlerë të drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	22,999,752	-	22,999,752	-
Detyrime financiare				
Detyrime të tjera	941,161	-	-	941,161

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumatat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. PARAQITJA DHE VLERESIMI I VLERES SE DREJTE (VAZHDIM)

	Me 31 dhjetor 2020			
	Vlera e mbartur	Vlera e drejte Nivel 1	Vlera e drejte Nivel 2	Vlera e drejte Nivel 3
Aktive financiare				
Mjete Monetare	33,754,996	-	-	33,754,996
Aktive te tjera	-	-	-	-
Detyrime financiare	7,234,442			7,234,442
Detyrime të tjera	2,138,253	-	-	2,138,253

7. AKTIVE AFATGJATA JO MATERIALE

Aktivitet afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
	Programe kompjuterike	Programe kompjuterike
Kosto		
Gjendja më 1 janar	7,324,442	-
Shtesa	1,595,672	7,324,442
Transferime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	8,920,114	7,324,442
Amortizimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar	-	-
Shpenzimi i periudhës	(1,767,153)	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31	(1,767,153)	-
Vlera kontabël neto		
Më 31 dhjetor	7,152,961	7,324,442

8. INVESTIME FINANCIARE

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Bono Thesari (vlera nominale)	23,000,000	-
Premium/discount	(476,196)	-
Interes i përlogaritur	451,340	-
Diferencë rivlerësimi	24,608	-
	22,999,752	-

Investimi është kryer në datë 19 janar 2021, me vlerë nominale 23 milion lekë, yield 2.12%.

9. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHMET ME TO

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to për 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhëse me Bankën Credins	9,406	-
Banka e Pare e Investimeve	(16)	-
Llogari rrjedhëse me Bankën Amerikane te Investimeve	1,533,737	33,754,996
Totali	1,543,127	33,754,996

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

10. DETYRIME TE TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë	780,878	152,151
Sigurime shoqërore	111,092	87,278
Tatim mbi te ardhurat për tu paguar	-	66,160
Tatim mbi vlerën e shtuar për tu paguar	47,550	1,221,616
Të tjera	1,641	611,048
	941,161	2,138,253

11. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht i Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 është si vijon:

Më 31 dhjetor 2021				
Monedha	Nr. i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek
LEK	45,000	1,000	45,000,000	45,000,000
	45,000			45,000,000
Më 31 dhjetor 2020				
Monedha	Nr. i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek
LEK	45,000	1,000	45,000,000	45,000,000
	45,000			45,000,000

12. TË ARDHURA NGA INTERESAT

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Amortizim Premium/skonto bono thesari	494,341	-
Fitim nga shitja e letrës	8,562	-
	502,903	-

13. TË ARDHURA NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet paraqiten si ne vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbime që jepen përgjatë periudhës:		
Tarife e administrimit te fondeve	2,724,341	-
Tarifa të tjera	-	-
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	-	-
Shërbime komisione mirëmbajtje llogarie	66,714	2,000
Shërbime arkëtimesh e pagesash	-	27,063
Shpenzime për tarifa dhe komisione	66,714	29,063
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	2,657,627	(29,063)

14. SHPENZIMET E PERSONELIT

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga dhe bonuse	5,426,045	4,230,546
Sigurimet shoqërore	616,220	370,153
Trajnime dhe shpenzime të tjera të ngjashme	-	-
Totali	6,042,265	4,600,699

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumatat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

15. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime mirëmbajtje software	1,630,806	-
Shërbime të tjera të jashtme (Auditorët e Jashtëm)	656,483	275,781
Shpenzime Marketingu	389,005	7,100
Tarifa Regjistrimi	273,963	250,000
Tarifa Administrimi	103,700	-
Taksa bashkiake	74,500	80,083
Shërbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	42,857	715,299
Pritje/përcjellje	35,131	-
Tarifa Licencimi (Web)	24,411	6,504
Penalitete	1,000	50,000
Kancelari	-	3,220
Të tjera	13,271	39,344
Totali	3,245,127	1,427,331

16. TATIM FITIMI

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Viti aktual	-	-
Rregullime për vitin e mëparshëm	-	-
Shpenzimi aktual i tatim fitimit	-	-
Efekti tatimor si rezultat i diferencave të përkohshme	-	-
Tatimi i shtyrë	-	-
Shpenzimi i tatim fitimit	-	-

Rakordimi i shpenzimit të tatim fitimit me fitimin/(humbjen) kontabël për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi / (humbja) kontabël para tatimit	(7,891,841)	(6,058,815)
Shpenzime të pazbritshme	732,230	202,871
Fitimi Tatimor përpara njohjes së humbjeve të bartura	(7,159,611)	(5,855,944)
Njohja e humbjeve të bartura	-	-
Baza e tatueshme	(7,159,611)	(5,855,944)
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat në 15%	-	-

14. TATIM FITIMI (VAZHDIM)

Shpenzimet e pazbritshme janë të detajuara si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime të panjohura, provigjone shpenzimesh pa fatura	732,230	202,871
Totali	732,230	202,871
Llogaritur 15%	109,834	30,431

ABI INVEST SH.A.

Shënime të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjithë shumat në Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

17. VEPRIME ME PALET E LIDHURA

Palët quhen te lidhura kur njëra prej tyre ka mundësinë të kontrollojë palët e tjera ose të ushtroje ndikim domethënës në vendim-marrjen financiare dhe operacionale të tyre. Për të vlerësuar çdo marrëdhënie të mundshme të palëve të lidhura, vëmendja i është kushtuar thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm anës ligjore të saj.

Shoqëria ka marrëdhënie me pale të lidhura me mëmën ("Banka Amerikane e Investimeve sh.a.") dhe stafin drejtues. Struktura e aksionareve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 paraqitet në shënimin 1.

Në datat respektive të mbylljeve të raportimit, Shoqëria ka gjendjet e mëposhtme me palët e lidhura:

Transaksionet	31 dhjetor 2021	
	Drejtuesit e shoqërisë	Banka Amerikane e Investimeve
Aktive		
Llogari rrjedhëse	-	33,754,996
Detyrime		
Detyrime të përlogaritura	-	-
Te ardhura		
Te ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime		
Shërbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	-	712,858
Shpenzime nga tarifa dhe komisione	-	-
Shpenzime operative	-	-
Pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqiten si më poshtë:		
Paga	2,645,455	
Bonuse	500,000	

Transaksionet	31 dhjetor 2020	
	Drejtuesit e shoqërisë	Banka Amerikane e Investimeve
Aktive		
Llogari rrjedhëse	-	1,543,127
Detyrime		
Detyrime të përlogaritura	-	-
Te ardhura		
Te ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime		
Shërbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	-	42,857
Shpenzime nga tarifa dhe komisione	-	-
Shpenzime operative	-	-
Pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqiten si më poshtë:		
Paga	4,863,545	-
Bonuse	562,500	-

18. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA

Pretendime për çështje ligjore

Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka çështje apo pretendime ligjore që mund të kenë impakt në këto pasqyra financiare.

19. NGJARJE TË MËPASSHME

Më 24 mars 2020, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243, në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përhapjes së virusit COVID19 dhe klasifikimit të tij si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 12 mars 2020. Shoqëria ka vlerësuar ndikimin e mëtejshëm të zhvillimeve dhe masave të ndërmarra për situatën epidemiologjike pas përfundimit të periudhës raportuese dhe nuk i vlerëson si ngjarje të cilat kërkojnë korrigjim ose shpalosje shtesë në pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Nuk ka ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose shpalosje shtesë në këto pasqyra financiare.